



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 20 Prot.

Gjirokastrë, më 09/01/2023

**V E N D I M**

Nr. 01, datë 09.01.2023

**P Ë R**

**DETAJIMIN E BUXHETIT TË AKORDUAR NGA SHTETI PËR VITIN 2023**

Në zbatim të nenit 38 pika 3 të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr.20, datë 20.09.2019 të MASR dhe M.F.E "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; të nenit 19 pika 2 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë; propozimit të Administratorit nr.19, datë 06.01.2023, Senati Akademik mori në analizë draftin e paraqitur nga institucioni i administratorit për detajimin e buxhetit të akorduar nga shteti për vitin 2023 dhe


**V E N D O S I**

1. Të miratoj fondin e pagave për personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ në shumën 191.408.844 (njëqind e nëntëdhjetë e një milion, katërqind e tetë mij e tetëqind e dyzet e katër) lekë;
2. Të miratoj fondin e sigurimeve shoqërore në shumën 32.000.000 (tridhjetë e dy milion) lekë;
3. Të miratoj fondin për bursat e studentëve në shumën 9.171.155 (nëntë milion, njëqind e shtatëdhjetë e një mij e njëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë;

4. Të miratoj fondin për shpenzime operative në shumën 15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë, sipas këtyre zërave:
  - a. Fondin pagesat e senatit akademik dhe bordit të administrimit, në vlerën 6.000.000 (gjashtë milion) lekë;
  - b. Fondin për faturat fikse: energji, ujë, telefon, në vlerën 3.000.000 (tre milion) lekë;
  - c. Fondin për kërkime shkencore, në vlerën 3.000.000 (tre milion) lekë;
  - d. Fondin për dieta brenda dhe jashtë vendit ( ku përfshihen ekspedita për studentët si dhe levizjet për pjesmarrje në aktivitete shkencore, etj), në vlerën prej 3.000.000 (tre milion lekë) lekë;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
6. Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim;

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr. Bektash MEMA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 77 Prot.

Gjirokastër, më 19/01 /2023

**VENDIM**

Nr. 02, datë 19.01. 2023

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR PËR VITIN 2022 DHE  
DETAJIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2023**

Në zbatim të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërië", neni 38 pika 3; Statutit të universitetit neni 19 pika 1/c dhe 1/f. Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.01.2023,

**VENDOSI**

Të miratoj:

1. Raportin vjetor financiar për vitin 2022.
2. Detajimin e buxhetit për vitin 2023.
3. Vendimi, të cilit i bashkëlidhen raporti vjetor financiar për vitin 2022 dhe detajimi i buxhetit për vitin 2023, i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr. Bektash MEMA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
SENATI AKADEMIK

Nr 78 Prot.

Gjirokastrë, më 19.01/2023

VENDIM

Nr. 03, datë 19.01.2023

PËR

MIRATIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT PËR TË NGJITHA NIVELET 2023

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1 gërmat "ç"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 19, pika 2/b si dhe vendimit të Rektoratit nr.01 datë 18.01.2023, "Për strukturën e përgjithshme të institucionit dhe numrin e personelit sipas njësave". Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.01.2023,

VENDOSI

1. Të miratoj numrin e personelit të UGJ-së për të gjitha nivelet për vitin 2023, sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKSTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 79 Prot.

Gjirokastrë, më 19/01/2023

VENDIM

Nr. 04, datë 19.01.2023

PËR STRUKTURËN E PËRGJITHSHME TË UGJ-SË

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1/ç; të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 19 pika 2/b dhe pika 3/f si dhe vendimit të Rektoratit nr.02 datë 18.01.2023 "Për strukturën e përgjithshme të UGJ-së, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 19.01.2023;

VENDOSI:

1. Të miratojë strukturën e përgjithshme të UGJ-së sipas *Aneksit 1* bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr. Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
SENATI AKADEMIK

Nr 80 Prot

Datë 19.01 2023

**VENDIM**

Nr. 05, datë 19.01 2023

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**

Referuar nenit 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19 pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.01.2023, pasi diskutoji,

**VENDOSI**

1. Të miratoj memorandumin e mirëkuptimit midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Institutit Shqiptar të Medias, për zbatimin e projektit "Edukimi për Median dhe Informacionin për Mësuesit e Ardhshëm";
2. Memorandumi i bashkëlidhet këtij vendimi dhe hyn në fuqi menjëherë;
3. Memorandumi pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë;

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

4  
Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 81 Prot

Datë 19.01 2023

**VENDIM**

Nr. 06, datë 19.01 2023

**PËR**

**MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR, SHQIPËRI DHE GALWAY BUSINESS SCHOOL, IRLAND**

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej". Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.01.2023, pasi diskutoji mbi lidhjen e memorandumit të mirëkuptimit me Galway Business School,

**VENDOSI**

1. Të miratoj memorandumin e mirëkuptimit midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Galway Business School, e cila i bashkëlidhet këtj vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Memorandumi pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë;

**KRYETARI SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 82 Prot

Datë 19/01 2023

**VENDIM**

Nr. 07, datë 19.01 2023

**PËR**

**MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR, SHQIPËRI DHE MARWADI UNIVERSITY, INDIA**

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej". Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.01.2023, pasi diskutoji mbi lidhjen e memorandumit të mirëkuptimit me Marwadi University,

**VENDOSI**

1. Të miratoj memorandumin e mirëkuptimit midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Marwadi University, India;
2. Memorandumi i bashkëlidhet këtij vendimi dhe hyn në fuqi menjëherë;
3. Memorandumi pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë;

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK:**

**Prof.dr.Bektash MEMEJA**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
SENATI AKADEMIK

Nr 165 Prot.

Gjirokastrë, më 07/02/2023

**V E N D I M**

Nr. 08, datë 07.02.2023

**MIRATIMI I KRITEREVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË  
"BACHELOR", PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL 2 VJEÇAR,  
CIKLIT TË DYTË" TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2024 - 2025**

**DHE**

**MIRATIMI I KUOTAVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT PËR TËGJITHA CIKLET  
E STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe pika 3, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 76 pika 1; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 12 pika 1/j, neni 19 pika 3/i, j, neni 26 pika 1/n, si dhe propozimeve të Dekanëve të Njësisve Kryesore me shkresat nr.04/1 prot, datë 13.01.2023 të FESHSH-së, nr 5/2 prot, datë 16 .01.2023 të FSHN-së dhe nr. 02 prot, datë 16 .01. 2023 të FE-së, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës 07. 02. 2023,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë kriteret e pranimit për studentët në programet e ciklit të parë "Bachelor", për vitin akademik 2024 – 2025 ( sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi);
2. Të miratojë kriteret e pranimit për studentë në programet me karakter profesional 2 vjeçar për vitin akademik 2024-2025 (sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij vendimi);
3. Të miratojë kriteret e pranimit për studentët në programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2024-2025 (sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij vendimi);

4. Të miratojë kuotat e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programeve me karakter profesional 2 – vjeçar, programeve të ciklit të dytë “Master”, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, për vitin akademik 2023 – 2024 (sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij vendimi);
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektas MEMA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
SENATI AKADEMIK

Nr 166 Prot.

Gjirokastrë, më 07.02/2023

**V E N D I M**

Nr. 09, datë 07.02.2023

**MIRATIMI I NGARKESËS MËSIMORE VJETORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË  
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" PËR VITIN AKADEMIK 2022 – 2023.**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 59 pika 8, Rregullores së brendshme të UGJ-së, neni 31, si dhe udhëzimit nr. 29 datë 10. 09. 2018 të MASR-së "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 07.02.2023,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë ngarkesën mësimore vjetore të personelit akademik në universitetin "Eqrem Çabej", për vitin akademik 2022– 2023, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Pagesa e orëve suplementare të kryhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim dhe zbatim.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

Prof. dr Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 167 Prot

Datë 07.02 2023

**VENDIM**

Nr. 10, datë 07.02 2023

**PËR**

**MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR, SHQIPËRI DHE SHKENCAVE TË APLIKUARA "GOLUCHOWSKI, POLONI**

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej". Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 07.02.2023, pasi diskutoji mbi lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e Shkencave të Aplikuara,

**VENDOSI**

1. Të miratoj marrëveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Poloni;
2. Memorandumi i bashkëlidhet këtij vendimi dhe hyn në fuqi menjëherë;
3. Memorandumi pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë;

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**





REPUBLIKA ESHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 290 Prot.

Gjirokaštër, më . 03.03 /2023

**V E N D I M**

Nr. 11, datë 03.03 2023

**P Ë R**

**MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË PROGRAMIT TË  
PËRBASHKËT ME UNIVERSITETIN E SALENTOS (ITALI)  
BACHELOR NË "MENAXHIMI DIGJITAL",**

Në zbatim të: ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", nenet 80, 91 dhe akteve nënligjore në fuqi; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaštër, nenet 70, 75, 76; Rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej", neni 66; vendimit të Njesisë Bazë nr. 01, datë 01.03.2023; vendimit të Njesisë Kryesore nr. 03, datë 02.03.2023 dhe në zhvillim të shkresës të MAS, nr. 1233, datë 20.02.2023, me objekt "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimit", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 03. 03. 2023, diskutoi rreth dokumentacionit për fazën e dytë të programit të përbashkët me Universitetin e Salentos (Itali), "Bachelor" në "Menaxhim Digjital", si vijon:

- a. Rregullorja e studimit;
- b. Plani mësimor;
- c. Formati i diplomës.

**V E N D O S I**

1. Të miratoj rregulloren e studimit, planin mësimor dhe formatin e diplomës, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe së bashku me dokumentacionin e miratuar, i përcillet:

- a. MAS;
- b. Njësia përkatëse bazë të Fakultetit Ekonomik;
- c. Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Korrikulave të UGJ-së.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr. Beltrush MEMA**





REPUBLIKA ESHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 291 Prot.

Gjirokastër, më 03/03/2023

**VENDIM**

Nr. 12, datë 03.03 2023

**PËR**

**MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË PROGRAMIT TË  
PËRBASHKËT ME UNIVERSITETIN E MOLISES (ITALI)**

**BACHELOR NË**

**"MENAXHIM I TURIZMIT TË QËNDRUESHËM"**

Në zbatim të: ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 80, 91 dhe akteve nënligjore në fuqi; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, nenet 70, 75, 76; Rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej", neni 66; vendimit të Njësisë Bazë nr. 04, datë 28.02.2023; vendimit të Njësisë Kryesore nr. 02, datë 02.03.2023 dhe në zhvillim të shkresës (njoftimit) të MAS, nr. 1230, datë 20.02.2023, me objekt "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimit", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 03.03.2023, diskutoj rreth dokumentacionit për fazën e dytë të programit të përbashkët me Universitetin e Salentos (Itali), "Bachelor" në "Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm", si vijon:

- a. Rregullorja e studimit;
- b. Plani mësimor;
- c. Formati i diplomës.

**VENDOSI**

1. Të miratoj rregulloren e studimit, planin mësimor dhe formatin e diplomës, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi;



2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe së bashku me dokumentacionin e miratuar, i përcillet:

- a. MAS;
- b. Njësishë përkatëse bazë të Fakultetit Ekonomik;
- c. Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Korrikulave të UGJ-së.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR  
SENATI AKADEMIK

Nr 292 Prot

Datë 03/03 2023

**VENDIM**

Nr. 13, datë 03 03 2023

**PËR**

**MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR DHE UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Senati Akademik pasi diskutoi mbi propozimin e Rektorit, me objekt lidhjen e marrëveshjes me Universitetin e Tiranës,

**V E N D O S I**

1. Të miratoj marrëveshjen e bashkëpunimit midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Universitetit të Tiranës, e cila i bashkëlidhet këtj vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Marrëveshja pas protokollimit i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënjeve me jashtë;

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**





REPUBLIKA ESHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 401 Prot.

Gjirokastrë, më 27/03/2023

**V E N D I M**

Nr. 14 , datë 27.03.2023

**MIRATIMI HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË  
VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO - PEDAGOGJIKE**

Në zbatim të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 81, pika 1, 2, 3, Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Vendimit Nr. 185, datë 25.03.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar , Udhëzimin Nr. 3 , datë 15.02.2023 i MAS "Për Përcaktimin e Diplomave Universitare të Njëvlershme, të Ngjashme ose të Përafërta me Fushën/Lëndët e Mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe Kriteret për Hapjen e Programeve të Studimeve të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike", Udhëzimit Nr. 7, datë 06.03.2023 një ndryshim i udhëzimit Nr. 3. Datë 15.02.2023, nenit 67, të Statutit të universitetit "Eqrem Çabej" si dhe vendimit nr. 2, date 21.03.2023 të Njësisë Kryesore FESHSH, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej , në mbledhjen e tij të datës, 27. 03. 2023;

**V E N D O S I ;**

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko - pedagogjike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i kalon Bordit të Administrimit.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 402 Prot.

Gjirokastër, më 27/03/2023

**VENDIM**

Nr. 15, datë 27.03.2023

**MIRATIMI I FORMËS SË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E PËRBASHKËT TË  
STUDIMIT ME TITULL TË DYFISHTË NË CIKLIN E DYTË "MASTER I  
SHKENCAVE " NË ARKEOLOGJI, HISTORI DHE ADMINISTRIM I PASURIVE  
KULTURORE - ASPIC, NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E MAÇERATËS  
( ITALI )**


Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 91, pika 3, udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 për "Dokumentacioni dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Kreu IV, vendimit të Senatit Akademik, nr 43, datë 23.11.2022 "Për hapjen e programit të përbashkët të studimit "Arkeologji, Histori dhe Administrim i pasurive kulturore – ASPIC, diplomë në Master i Shkencave me titull të dyfishtë : "Master i Shkencave" në Histori dhe Arkeologji për inovacion" i universitetit të Maceratës (Itali) dhe "Master i shkencave " në Arkeologji, Histori dhe administrim i pasurive kulturor " i universitetit "Eqrem Çabej", udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 27.03.2023;

## VENDOSI:

1. Të miratojë formën e diplomës me titull të dyfishtë në ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” në Arkeologji, histori dhe administrim i pasurive kulturore, program i cili realizohet me 120 kredite në 2 (dy) vite akademike.
2. Formati i diplomës i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr. Bektash MEMA**





REPUBLIKA ESHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 403 Prot.

Gjirokastrë, më 27/03 /2023

## VENDIM

Nr. 16 , datë 27.03 2023

**MIRATIMI I DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË APLIKIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT ME TITULL TË DYFISHTË NË CIKLIN E DYTË "MASTER I SHKENCAVE " NË ARKEOLOGJI, HISTORI DHE ADMINISTRIM I PASURIVE KULTURORE - ASPIC, NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN E MAÇERATËS ( ITALI )**

Në zbatim të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 38 pika dh, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 19 pika 3/ h , neni 70 , vendimit nr. 879 datë, 18. 12. 2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018 , të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë " dhe udhëzimit nr. 1, datë 14. 01. 2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë " , si dhe referuar shkresës së MASR-së me nr. 1767 prot , datë 15.03.2023, me subjekt " Njoftim mbi vlerësimin e aplikimit", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej , në mbledhjen e tij të datës, 27. 03. 2023;

## VENDOSI;

1. Të miratojë dokumentacionin e fazës së dytë të aplikimit për hapjen e programit të përbashkët të studimit në ciklin e dytë të studimeve "Master i Shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore – ASPIC, me titull të dyfishtë : "Master i Shkencave" në

Histori dhe Arkeologji për Inovacion, në universitetin e Maceratës dhe “Master i Shkencave” në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore , në universitetit “Eqrem Çabej” :

- a. Planin mësimor
  - b. Rregulloren e programit të studimit
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. dr Bektash MEMA**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 410 Prot

Datë 28.03 2023

**VENDIM**

Nr. 17, datë 28.03 2023

**PËR**

**MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR, SHQIPËRI DHE SULEYMAN DEMIREL UNIVERSITY, TURKIYE**


Bazuar nenin 38, pika 3 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 19, pika 3/e të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej". Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 28.03.2023, pasi diskutoji mbi lidhjen e memorandumit të mirëkuptimit me Suleyman Demirel University,

**VENDOSI**

1. Të miratoj memorandumin e mirëkuptimit midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Suleyman Demirel University, Turkiye e cila i bashkëlidhet këtj vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë;
3. Memorandumi pas protokollimit të tij në tre gjuhë: shqip, turqisht dhe anglisht i përcillet sektorit të kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë;

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
SENATI AKADEMIK

Nr. 111 Prot.

Gjirokastrë, më 28/03 /2023

**VENDIM**

Nr. 18 datë 28.03 2023

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË SEKRETARINË E KOMISIONIT INSTITUCIONAL  
TË ZGJEDHJEVE, UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**


Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 131; rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej", neni 6, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 28.03.2023 diskutoj për procesin e aplikimit për sekretar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, pas dorëheqjes së paravokueshme të sekretarit në funksion deri në datën 27.03.2023, protokolluar me nr. 399, datë 27.3.2023,

**VENDOSI**

1. Kandidatët për sekretar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, përfaqësues i personelit të Universitetit "Eqrem Çabej", vetregjistrohen në Sekretarinë e Senatit Akademik, brenda dy ditëve kalendarike nga fillimi i procesit zgjedhor, data 03 dhe 04 prill 2023.
2. Vendimi i përcillet Komisionit Institucional të Zgjedhjeve.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr. Bektash MEMA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1117 Prot.

Gjirokastrë, më 05/04 /2023

**VENDIM**

Nr. 19 datë 05.04 2023

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË SEKRETARINË E KOMISIONIT INSTITUCIONAL  
TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 131; rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej", neni 6, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 05.04.2023, zgjodhi, me votim të fshehtë dhe me shumicën e thjeshtë të anëtarësisë së tij, sekretarin e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve. Nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë senati të pranishëm në mbledhje, me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro dhe asnjë kundër, Senati Akademik,

**VENDOSI**

1. Të zgjedh sekretar të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, përfaqësues të personelit të Universitetit "Eqrem Çabej", *Znj. Aida Sotiri*.
2. Vendimi i përcillet Komisionit Institucional të Zgjedhjeve për të vazhduar procedurat e procesit për zgjedhjet e përsëritura për autoritete drejtuese në Fakultetin Ekonomik, pranë Universitetit "Eqrem Çabej".
3. Rezultati i zgjedhjes publikohet në faqen zyrtare elektronike dhe në mjediset e UGJ-së.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

*[Signature]*  
**Prof.dr. Bektash MEMA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIRO KASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 517 Prot

Datë 19.04 2023

**VENDIM**

Nr. 20, datë 19.04 2023

**PËR AKORDIMIN E TITULLIT AKADEMIK "DOCTOR HONORIS CAUSA" Z.  
TRIANTAFYLLOS A.D. ALBANIS**

Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", kreu V pika 1; ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 3; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej, neni 19 pika 9, Senatit Akademik në mbledhjen e të datës 19.04.2023 shqyrtoj kërkesën e një grupi senatorësh, protokolluar me nr. 31, datë 11.1.2023, për akordimin e titullit akademik "Doctor Honoris Causa" z. Triantafyllos A.D. Albanis. Pasi konstatoj se ish-in respektuar të gjitha procedurat ligjore: kërkesa drejtuar MAS nr. 43, datë 16.01.2023 për dhënie pëlqimi për akordim titulli "Doctor Honoris Causa"; informacion dërguar MAS nr. 101, datë 23.01.2023 në mbështetje të kërkesës të sipërpërmendur; dhënje pëlqimi nga MAS me shkresën nr. 302/1, datë 07.2.2023 për akordimin e titullit "Doctor Honoris Causa" z. Triantafyllos A.D. Albanis, me shumicën absolute të të gjithë anëtarësisë,

**VENDOSI**

1. T'i akordohet titulli akademik "Doctor Honoris Causa" z. Triantafyllos A.D. Albanis, me motivacionin:

*“Personalitet me aftësi të spikatura drejtuese e kontribute gjurmëlënëse për të menaxhuar ndryshimet në botën akademike dhe më gjerë; burim frymëzimi dhe lider në kërkimin e zgjidhjeve inovative për ngjarjet e rëndësishme të kohës së sotme; misionar në ndërtimin e një bote më të mirë dhe më të zgjuar; me kontribut të veçantë për përafrimin e standarteve të Universitetit “Eqrem Çabej” me ato të hapësirës evropiane”*

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.dr.Bektash MEMA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
SENATI AKADEMIK**

Nr 640 Prot.

Gjirokastrë, më 16.05.2023

**V E N D I M**

Nr. 21 , datë 16.05.2023

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS, SË RISHIKUAR NË UGJ**


Në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtat e informimit"; të urdhërit nr. 187 datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar", të ndryshuar me urdhër nr. 35, datë 31.03.2021; nenet 6 pika 1/c dhe 23 pika 2/b të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës, 16.05.2023,

**V E N D O S I ;**

1. Të miratojë programin e rishikuar të transparencës të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në kuadër të detyrimeve që vijnë nga ligji për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen zëvendës rektorët dhe koordinatori për të drejtën e informimit;
3. Këtij vendimi i bashkëlidhet Programi i Transparencës së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

Prof. dr. Bekdash MEMA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 823 Prot.

Gjirokastër, më 14 / 06 / 2023

## V E N D I M

Nr 22, datë 14 . 06 . 2023

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTIT "RRITJA E NIVELIT ARSIMOR DHE KËRKIMIT SHKENCOR TË MENAXHIMIT DIGJITAL" BASHKËPUNIMI FUQIZUES MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" DHE UNIVERSITETIT TË SALENTOS**

Në zbatim të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 3; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, neni 70; si dhe bazuar në thirrjen e hapur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Nr. 3609/1 Prot., datë 07.06.2023, "Për financimin e IAL-ve publike për projekte të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2023-2024". Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 14.06.2023,

## V E N D O S

**Të miratojë projektin:**

1. Rritja e nivelit Arsimor dhe Kërkimit Shkencor të Menaxhimit Digjital: Bashkëpunimi fuqizues midis Universitetit "Eqrem Çabej" dhe Universitetit të "Salentos".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1041 Prot.

Gjirokastër, më 10/10/2023

VENDIM

Nr. 23 datë 10.08.2023

PËR  
MIRATIMIN E PROJEKTBUXHETIT PËR VITIN 2024 DHE PLANIN BUXHETOR  
AFATMESËM 2024-2026

Në mbështetje të: ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1/h; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 19 pika 2/c; Relacionin mbi parashikimin e Projekt - Buxhetit të vitin 2024 dhe planin buxhetor afatmesëm 2024-2026, përcjellë Senatit Akademik nga Administratori i UGJ-së, me shkresë nr. 1024 datë 07.08.2023, anëtarët e Senatit Akademik të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, pasi u konsultuan me draftin e përmendur deri në datën 10.08.2023, u shprehen në mënyrë elektronike për miratimin e tij. Mbi këtë bazë u mor

V E N D I M I

1. Të miratohet unanimsisht (me të gjitha votat e senatorëve që u prononcuan) projektbuxheti i Universitetit "Eqrem Çabej" për vitin 2024 dhe plani buxhetor afatmesëm 2024-2026.
2. Këtij vendimi i bashkëngjitet drafti i projekt-buxhetit dhe fletet e votimit online të senatorëve.
3. Një kopjo e vendimit i percillet Bordit të Administrimit për veprim të mëtejshëm.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

  
Prof.dr.Bektash MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1236 Prot.

Gjirokastrë, më 28/09/2023

VENDIM

Nr. 24, datë 28.09.2023

PËR

MIRATIMIN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË (NJSBC)

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 103; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", nenet 93-96; Vendimin e Senatit Akademik nr. 38, datë 09.12.2020; Vendimin e Rektoratit Nr. 12, datë 26.09.2023, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës 28.09.2023 diskutoi për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UGJ-së. Në përfundim të mbledhjes Senatit Akademik,

VENDOSI

- Të miratojë përbërjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të UGJ-së me shtatë anëtarë si më poshtë:
  - Prof.dr. Jaho Cana, përfaqësues i Rektoratit;
  - Prof.dr. Lavdim Hasani, përfaqësues i Fakultetit të Shkencave të Natyrës;
  - Prof.as.dr. Valbona Duri, Përfaqësuese e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;
  - Dr. Eduina Guga, përfaqësuese e Fakultetit Ekonomik;
  - Klaviola Dudumi, Përfaqësuese e stafit ndihmës akademik administrativ;
  - Irma Gjollëshi, Përfaqësuese e stafit ndihmës akademik administrativ;
- Vendimi u përcillet Zëvendës Rektorëve, Drejtuesve të Njësive Kryesore dhe anëtarëve të NJSBC.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr. Bektash MEMA





REPUBLIKA ESHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr. 1237 Prot.

Gjirokastrë, më 28/09/2023

**V E N D I M**

Nr. 25, datë 28.09.2023

**P Ë R**

**MIRATIMIN E DOKUMENTIT NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË "RAPORT I MONITORIMIT TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR"**


Në zbatim të masave dhe rekomandimeve të përcaktuara në Raportin e Monitorimit të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti "Eqrem Çabej", me nr. 3276/5, datë 07.09.2023, protokolluar nga UGJ me Nr. 1109, datë 08.09.2023, si dhe duke respektuar me korrektësi aktet ligjore e nënligjore si vijon: ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e lartë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar; udhëzimin nr. 29 datë, 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të lartë", i ndryshuar; udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar; udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor"; udhëzimin nr. 16, datë 08.07.2019 "Për paisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themelitar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej, pasi diskutoi rreth dokumentit të miratuar nga Rektorati "Në zbatim të rekomandimeve të përcaktuara në Raportin e Monitorimit të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës 28.09.2023,

## VENDOSI

1. Të miratojë dokumentin në zbatim të rekomandimeve të “Raport i monitorimit të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër”, i cili i bashkëlidhet si aneks këtij vendimi;
